



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:113126

Datë: 30.01.2025

Numri i dokumentit: 06782370

KA.nr.545/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Agromarket Ks” SH.P.K, më përfaqësues N.S, me seli në Magjistralen Prishtinë-Shkup km 6, Llapllasellë, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat Shefqet M.Rexha, kundër të paditurës Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë-AUV, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit me nr.554 të datës 30.06.2020, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit kryesor publik me datë 20.01.202, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur, më datë 30.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET pjesërisht e bazuar** kërkesëpadia e paditësi “AgromarketKs” SH.P.K, kundër të paditurit Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë-AUV.
- II. **ANULOHET si e kundërligjshëm** vendimi me nr.554 i datës 30.06.2020 dhe çështja i kthehet ne rivendosje.
- III. **REFUZOHET** kërkesa e paditësit që të obligohet e paditura Agjencinë i Ushqimit dhe Veterinarisë AUV që për shkak të dëmit të shkaktuar si pasojë e ndalesës së shitjeve të preparateve për mbrojtjen e bimëve dhe vendimi i kundërligjshëm kompensimin shumë prej 23,538.72 euro (njëzet e tremijë e pesëqind e tridhjetë e tetë e shtatëdhjetë e dy euro) bazuar sipas ekspertizës financiare si dhe t’ia paguaj paditësit shumë prej 1,098.80 euro (një mijë e nëntëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë

cent) në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore sipas tarifës së OAK-së, si e pabazuara.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 14.09.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës- Departamenti për Çështje Administrative paditësi “AgroMarket KS ”SH.P.K , me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të tij me autorizim ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.15274/20, kundër të paditurës Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit me nr.554 të datës 30.06.2020 me propozim që Gjykata të aprovoj si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, të anuloj vendimin me nr.554 të datës 30.06.2020, si dhe të detyrohet i padituri që për shkak të dëmit të shkaktuar si pasojë e ndalesës së shitjeve të prepareteve për mbrojtjen e bimëve dhe nga vendimi i kundërligjshëm, kompensimin shumë prej 23,538.72 euro (njëzet e tremijë e pesëqind e tridhjetë e tetë e shtatëdhjetë e dy euro) bazuar sipas ekspertizës financiare si dhe t’ia paguaj paditësit shumë prej 1,098.80 euro (një mijë e nëntëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë cent) në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore sipas tarifës së OAK-së.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 545/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor më datë 05.06.2024, pastaj më datë 20.01.2025 konform nenit 41 të LKA-së, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit avokat Shefqet Rexha, sipas autorizimit të datës 25.03.2024, ndërsa në mungesë të përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur nga avokatura shtetërore, të ftuar në mënyrë të rregullt të cilët përmes emailit kanë dorëzuar parashtrësë për deklarimin e mungesës në seancë, si dhe me pjesëmarrje të ekspertit financiar Z. Fitim Rraci.

Pretendimet e palës paditëse

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë shqyrtimit të seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se më datë 30.06.2020 e paditura ka nxjerr vendim me Nr. 554 për ndalimin e shitjes duke ndaluar kompanisë plasmanin e Produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) pa të drejtë pasi që ato janë në pajtim me autorizimin, paketimin, etiketimi, klasifikimin, lejet, udhëzimet për përdorim, përbërjet kimike.
5. Ka shtuar se arsyet e kundërshtimit të vendimit janë se kompania tan paditës posedon dokumente si: çertifikatë autorizimi me numër të regjistrimit 75-3592-2019 të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Departamenti i Politikave Bujqësore dhe i Tregtisë i cili është valid deri më datë 30.11.2020, lejen për importim të produkteve për mbrojtjen e bimëve nr. prot. 4593 dhe leje për person përgjegjës në barnatore bujqësore nr. prot. 4594 të dyja në afat deri më datë 02.11.2020.
6. Ka theksuar se vendimi i kundërshtuar është në kundërshtim me vërtetimin e gjendjes faktike , pasi që kompania ka respektuar të gjithë legjislacionin relevant në fuqi kur ka bërë importimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve. Gjatë inspektimit ashtu siç edhe e kanë konstatuar inspektorët në PMB janë etiketat në gjuhën serbe dhe shqipe, që nënkupton se paditësi ka respektuar në tërësi dispozitën e nenit 5 të Udhëzimit Administrativ 13/2009 ku në par. 1. përcaktohet se *“Në ambalazh duhet të vendoset etiketa në gjuhën e përdoruesit”* si dhe dispozitat e Ligjit N.r 028/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Kosovës. Po ashtu paditësi është në harmoni edhe me UA 17/2014 përkatësisht neni 4 dhe 5 dhe ët Ligjit Nr. 03/L-042 pasi që kjo bazë ligjore ka qenë në fuqi edhe në kohën kur këto produkte janë importuar në Kosovë dhe pikërisht etiketimi dhe tregtimi i produkteve është bërë mbi këtë bazë, me çka dëshmohet edhe përmes komunikimeve të emailave që kanë bërë inspektorët e AU-V-së me prodhuesin e produkteve të PMB-ve (Bayer AG) nga ku kanë marr konfirmim se të gjitha produktet janë origjinale dhe në përputhje me standardet sipas ligjit të PMB-së, prandaj paditësi nuk ka bërë asnjë shitje që është në kundërshtim me legjislacionit relevant në fuqi. Në seancën e datës 05.06.2024 i njëjti ka bërë precizimin e padisë në kuptimin objektiv sa i përket kompensimit të dëmit të shkaktuar nga vendimi i së paditurës, duke propozuar që të caktohet një ekspertizë financiare për llogaritjen e dëmit të shkaktuar nga vendimi i

kundërshtuar me padi nga e paditura, ndërsa sipas parashtrës së datës 20.01.2025 i njëjti ka bërë plotësimin e petitumit të padisë ashtu që i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit “Agromarket Ks” SH.P.K ., të anulohet vendimi Nr. 554 i datës 30.06.2020 si i kundërligjshëm, të obligohet e paditura Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë AUV- që për shkak të dëmit të shkaktuar si pasojë e ndalesës së shitjeve të preparateve për mbrojtjen e bimëve dhe vendimi i kundërligjshëm kompensimin shumë prej 23,538.72 euro (njëzet e tremijë e pesëqind e tridhjetë e tetë e shtatëdhjetë e dy euro) bazuar sipas ekspertizës financiare si dhe t’ia paguaj paditësit shumë prej 1,098.80 euro (një mijë e nëntëdhjetë e tetë euro e tetëdhjetë cent) në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore sipas tarifës së OAK-së.

Kundërshtimet e palës së paditur

7. Përfaqësuesja e të paditurës në pretendimet e dhëna përmes përgjigjes në padi të parashtruar sipas parashtrës së datës 07.05.2024 ka deklaruar se e paditura e kundërshton në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Bazuar në Inspektimin e inspektorëve sipas procesverbalit me nr. ref: 000768-000770 të datës 08..04.2020 të cilët kanë konstatuar se janë gjetur preparate të evidentuara të cilat janë të ndaluara për shitje si dhe jo të rregullta, ndërsa ndalesa për shitje të PMN-ve është rikonfirmuar edhe sipas vendimit me nr.ref. 04/3-248 të datës 21.04.2020.
8. Tutje ka shtuar se po ashtu më datë 25.06.2020 inspektorët fito- sanitar kanë dalë për verifikim të ndalesën së dhënë për mos shitjen e PMB-ve verifikim të gjendjes për konstatim në lidhje me ndalesën paraprake., ku përmes procesverbalit me nr. 001630 të datës 25.06.2020 është konstatuar se subjekti në fjalë nuk e ka zbatuar ndalesën për shitjen e PMB-ve që do të thotë se PMB të ndaluara për shitje nuk janë hasur të gjitha pasi që një pjesë tyre janë shitur.
9. Përfundimisht ka theksuar se vendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, ndërsa pala paditësi pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar me asnjë provë të vetme. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpapia e paditësit dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar me padi.

Provat e administruara

10. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administrua këto prova: Vendimi me Nr. AUV-Ref.04/3-248/2020 me datë 21.04.2020 i lëshuar nga Inspektori Hidrosanitar i AUV-së, Procesverbali me nr.000768 për Inspektimin e kryer me datë 08.04.2020, vazhdim me nr.000769, 000770, Vendim me nr.Ref-04/3-719 me datë 29.06.2020, me Nr.Prot:554 me datë 30.06.2020 i nxjerrë nga Kryeshefi i Agjencisë, Procesverbal për inspektimin e kryer me nr.001630 me datë 25.06.2020, vazhdim me nr.001631, Ankesë e paditësit Agromarket KS e datës 07.07.2020-ankesa nuk përmban vulën e pranimit nga e paditura, Dëshmi e dorëzimit në zyrën postare DHL me datë 07.08.2020, Ankesë nga paditësi tek AUV për shkak të heshtjes administrative lidhur me vendimin e kundërshtuar- dëshmia e dorëzimit në zyrën postare me datë 25.08.2020, Komunikimi me email me datë 26 dhe 27 maj 2020 në mes përfaqësuesit të paditësit N.S dhe përfaqësuesit të kompanisë Bayer, Kërkesë nga I. F e dorëzuar përmes emailit me datë 21.05.2020, si përfaqësues i sektorit fitosanitar me të cilën kërkon konfirmim nga Kompania Bayer.com, Komunikim përmes emailit nga përfaqësuesit e kompanisë Bayer drejtuar Inspektorit fitosanitar I. F me datë 04.06.2020, Komunikim përmes emailit me datë 05.06 dhe 01.06.2020 në mes të përfaqësuesve të kompanisë Bayer dhe inspektorit fitosanitar I. F, Njoftim lidhur me ankesën nga AUV për paditësin me datë 11.09.2020, Ekspertiza Financiare e pranuar në gjykatë më datë 03.12.2024 punuar nga eksperti gjyqësor financiar Fitimi Raci.
11. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar. Nga provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:
12. Inspektori I. F me kerkese te dorëzuar përmes emailit me datë 21.05.2020, si përfaqësues i sektorit fitosanitar kërkon konfirmim nga Kompania Bayer.com, me arsyetim se shumica e produkteve për mbrojtjen e bimëve nuk i plotësojnë kushtet për tu tregtuar në tregun e Republikës së Kosovës, pasi që në Legjislacionin e Kosovës është e ndaluar çdo ndërhyrje në etiketën e prodhuesit derisa produktet që vijnë nga kompania paditësit kanë

ndërhyrje në Etiketat Origjinale si p.sh. te preparati Previcur Energy 1 L i cili në etiketën e parë origjinale është në gjuhën serbe me e numër të vendimit të Drejtorisë për Mbrojtjen e Bimëve të Republikës së Serbisë. Etiketa tjetër e vendosur mbi të është në gjuhën shqipe e deklaruar si Previcur Energy 840 SL me numër tjetër të vendimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pastaj në etiketën e parë, duke i kërkuar që të konfirmoj se ky falsifikim a është bërë nga ata.

13. Përfaqësuesit e kompanisë Bayer drejtuar Inspektorit fitosanitar I. F me datë 04.06.2020, përmes emailit kane njoftuar se produktet e dorëzuara në Kosovë nga Serbia dhe Bayer DOO, kanë etiketa origjinale, të përshtatshme të bëra dhe të përdorura nga Bayer dhe se këto produkte nuk janë falsifikuar.
14. Në Inspektimin e kryer me datë 08.04.2020 Procesverbali me nr.000768 për vazhdim me nr.000769, 000770, nga Inspektorët është konstatuar se në momentin e inspektimit të PMB-ve në depon e subjektit u konstatua se Licenca për import të PMB-ve është valide deri më datë 02.11.2020, Licenca e personit përgjegjës në emër të N.M me numër protokollit 454, valide deri më datë 02.11.2020, Preparate me mbi etiketim në gjuhën shqipe, ndërsa etiketën bazë në gjuhën serbe me alfabet cirilik. U konstatuan Leopard” 5EC 1/1 32 paketime, “Orius” 15 EË 5 paketime, “Equip” 5 paketime, “Luna” 2 paketime, “Decis” 2,5 EC 19 paketime, “Movento” 100 SC 4 paketime, “Prosario” 2 EC 2 paketime, “Folpan” 80 ËG 75 paketime. Kohiemr 7005 SL =480x0,01litra tek i cili etiketa është në gjuhën shqipe në të cilin skenohet numri i regjistrimit ndërsa në etiketën bazë ka numër 2454. Orius” 25 EË në sasi prej 240 copë x 0,05 litra, tek i cili është i shtypur nr. 510, ndërsa preparati “Mavrik” 2F në sasi 36 copë x 0,25; litra ka numrin 487. Preparati “Adengo” në si 39 copë X0,200 litra ka udhëzimin bazë të përdorimit në gjuhën serbe me alfabet cirilik, ndërsa mbi këtë udhëzim e ka të vendosur etiket në gjuhën shqipe. Gjatë kohës së zhvillimit të inspektimit personi përgjegjës ishte i pranishëm, ku pronari i subjektit afarist ka ofruar dokumentacionin e kërkuar në formë të fotokopjes. Në pjesën urdhëruese të procesverbalit nga inspektorët është ndaluar distribuimi dhe tregtimi i PMB-ve në kundërshtim me Ligjin 03/L-042 dhe UA nr. 17/2014 deri ne një vendim nga MBPZHR-AUV.
15. Nga Vendim me Nr. AUV-Ref.04/3-248/2020 më datë 21.04.2020 i lëshuar nga Inspektori Hidrosanitar i AUV-së, paditësit AgromarketKs” SH.P.K i është ndaluar

Distribuimi dhe Tregtimi i PMB-ve, me arsyetim se gjatë kontrollit të rregullt inspektues më datë 08.04.2020 sipas procesverbaleve të inspektimit me nr. 000768, 000769 dhe 000770 në lokalet afariste të “Agromarket Ks”SH.P.K , inspektorët sanitar kanë gjetur se i njëjti ka lëshuar për tregtim Preparate për Mbrojtjen e Bimëve (PMB) në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Në bazë të gjendjes faktike gjatë inspektimit është konstatuar se PMB me mbi etiketime d.m.th etiketën bazë e kanë në gjuhën serbe dhe atë me alfabet cirilik, ndërsa mbi këtë është e vendosur një etiketë në gjuhën shqipe ku janë të shënuara të dhëna jo të mjaftueshme për etiketim. “Leopard” 5EC 1/132 paketime, “Orius” 15 EË 5 paketime, “Equip” 5 paketime, “Luna” 2 paketime, “Decis” 2,5 EC 19 paketime, “Movento” 100 SC 4 paketime, “Prosario” 2 EC 2 paketime, “Folpan” 80 EË 75 paketime. Në preparatin “Kohinor: 200 SL 480 paketime në etiketën origjinale nuk është shënuar numri i regjistrimit të MBPZHR-së por një numër 2454 (që tregon se preparati është i regjistruar më këtë numër të Shqipëri) Në të njëjtën etiketë është edhe preparati “Orius” 25 EË në sasi prej 240 copë x 0,05 litra, tek i cili është i shtypur nr. 510, ndërsa preparati “Mavrik” 2F në sasi 36 copë x 0,25 ;litra ka numrin 487. Preparati “Adengo’ në sasi 39 copë X0,200 litra ka udhëzimin bazë të përdorimit në gjuhën serbe me alfabet cirilik, ndërsa mbi këtë udhëzim e ka të vendosur etiketë në gjuhën shqipe.

16. Procesverbal për inspektimin e kryer me nr.001630 me datë 25.06.2020, vazhdim me nr.001631, bazuar në Ligjin e PMB-ve nr. 03/L-042 dhe të Udhëzimit Administrativ të AUV-it gjatë kontrollit është konstatuar si në vijim: se nga dokumentet janë prezantuar, licencat e importit dhe tregtimit, preparatet e ndaluara për shitje me proces dhe vendimit mbi ndalimin e PMB-ve të datës 21.04.2020, pjesërisht gjenden në depo, por një pjesë e tyre edhe janë shitur si: Leopard 32 pako/mungoj 8 pako, orius 25 nga 5 pako, mungojnë të gjitha, equip nga 5 pako mungojnë të gjitha, luna 20 pako të gjitha janë në depo, decis 2,5 19 pako, mungojnë 15 pako, movento 4 pako mungojnë 15 pako, prosao 250 EC 2 pako, janë të gjitha në depo, Foplan 80 EËDG 75 copa mungojnë të gjitha, Kohinor të gjitha pakot në depo, Mavrik të gjitha pakot në depo, Adengo 39 copë mungojnë të gjitha janë në depo. Preparatet e importuara nga 3 fatura e fundit janë të gjitha në rregull dhe sasi të janë të përputhshme me faturat. Preparati “Folpan’ 80 nuk është gjetur në depo Pala deklaroi se ky preparat është porositur specifikisht për “Stonecastle” Në pjesën urdhëruese inspektorët kanë urdhëruar që produktet PMB m e lartcekura nuk lejohet të tregtohen dhe të tera të ngjashme siç është përshkruar më lart.

17. Paditësi “Agromarket KS” më datë 07.07.2020 ka parashtruar ankesë, kundër vendimit me nr. 554 të datës 30.06.2020. Me Vendimi me nr.Ref-04/3-719 me datë 29.06.2020, me Nr.Prot:554 me datë 30.06.2020 i nxjerrë nga Kryeshefi i Agjencisë, është ndaluar shitja e PMB-ve të subjektit “Agromarket-KS” DOO, i bazuar në procesverbalin nr. 001630-001631 i datës 25.06.2020 e cila ndalesë vlen për produktet dhe sasi të e evidentuara në procesverbalin e lartcekur, për produktet si në vijim: Leopart 24 paketime, Luna 20 paketime, Moënto 4 paketime, Prosao 250 EC 2 paketime, Kohinor 48 paketime , me arsyetim se inspektorët fitonsanitar të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në rastin e ri- inspektimit kanë konstatuar se preparatet për mbrojtjen e bimëve (PMB-ve) të evidentuara dhe të ndaluara për shitje me procesverbalin 00768-000770 të datës 08.04.2020 për të cilat në fakt është lëshuar vendimi me numër 72 i datës 21.04.2020, mbi ndalimin e shitjes, një sasi e konsideruar e tyre tani më janë shitur, që do të thotë urdhër-ndalesa nuk është respektuar nga subjekti afarist në fjalë. Është konstatuar gjendje e re faktike pasi që ka dallime në sasi e që për sasi të e evidentuar të PMB-ve tani që janë në depo, përsëri me procesverbalin nr. 001630-001631 të datës 25.06.2020 është vendosur ndalesë për shitje. Nga Dëshmi e dorëzimit në zyrën postare DHL me datë 07.08.2020, përmes së cilës dëshmohet se paditës ka parashtruar ankesën.
18. Paditësi ka parashtruar ankesë tek AUV për shkak të heshtjes administrative lidhur me vendimin e kundërshtuar e dorëzuar në zyrën postare me datë 25.08.2020.
19. Njoftim lidhur me ankesën nga AUV për paditësin me datë 11.09.2020. duke e njoftuar se organi kompetent AUV-Inspektorati Sanitar nuk ka arritur që brenda afatit ligjor, për shkak të mungesës së stafit të shkakuar nga gjendja e pandemisë të shqyrtoj ankesën e juaj të datës 09.07.2020 me numër të protokollit 3726, andaj konform ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Inspektori ka vepruar konform nenit 100 par. 1 i këtij ligji.
20. Ekspertiza Financiare e pranuar në gjykatë më datë 03.12.2024 punuar nga eksperti gjyqësor financiar Fitimi Raci, në të cilën është konstatuar dëmin si pasojë e ndalesës së shitjeve të preparateve për mbrojtjen e bimëve –PMB-ve, sipas klasifikimeve dhe sasive të përshkruara si në diapozitivin e vendimit të kundërshtuar me padi, përfshinë shumën e përgjithshme prej 23,538.72 euro. Këtu janë përfshire shpenzimet proporcionale të qirasë që lidhen me magazinimin e mallrave të ndaluara janë në shumë prej 2,568.12 euro për periudhën duke filluar nga data 30.06.2020 deri më datë 30.11.2024.

21. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar.
22. Gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*.
23. Gjykata vlerësoj se me Inspektorët Fitosanitar të së paditurës Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) përmes vendimit AUV-Ref.04/3-248/2020 të datës 21.04.2020 subjektit afarist tani paditësit ia ka ndaluar distribuimin dhe tregtimin e Preparateve për Mbrojtjen e Bimëve (PMB), me arsyetim se paditësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit në fuqi, konkretisht të Ligjit nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, dhe të Udhëzimi Administrativ Nr.13/2009 për Caktimin e Kushteve, Objekteve dhe Pajisjeve për Vendosjen në Treg të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve dhe Udhëzim Administrativ 17/2014 për Klasifikim, Etiketim dhe Paketim të Kimikateve të Rrezikshme. Me tutje thuhet se sipas procesverbalit për inspektim me nr. 000768, 000769, 000770 të datës 08.04.2020 në objektin e paditësit, ku është vlerësuar se PMB-të janë me mbi etiketime, etiketën bazë e kanë në gjuhën Serbe, ndërsa mbi këtë është vendosur etiketë në gjuhën shqipe, mirëpo janë të shënuara të dhëna jo të mjaftueshme për etiketim. Preparatet e tilla janë cilësuar të jenë: “Leopard” 5EC 1/1 .32 paketime, “Orius” 15 EË 5 paketime, “Equip” 5 paketime, “Luna” 2 paketime, “Decis” 2,5 EC 19 paketime, “Movento” 100 SC 4 paketime, “Prosario” 2 EC 2 paketime, “Folpan” 80 EË 75 paketime. Kohiemr 7005 SL =480x0,01litra tek te cilat etiketa në gjuhën shqipe skenohet numri i regjistrimit ndërsa në ë etiketën bazë ka numër 2454. Orius” 25 EË në sasi prej 240 copë x 0,05 litra, tek i cili është i shtypur nr. 510, ndërsa preparati “Mavrik” 2F në sasi 36 copë x 0,25; litra ka numrin 487. Preparati “Adengo” në sasi 39 copë X0,200 litra ka udhëzimin bazë të përdorimit në gjuhën serbe me alfabet cirilik, ndërsa mbi këtë udhëzim e ka të vendosur etiketën ën gjuhën shqipe, duke i

ndaluar këtij subjekti afarist distribuimin dhe tregtimin e PMB-ve në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-042 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 17/2014 deri në një vendim nga organi kompetent.

24. Ndërsa e paditura më datë 30.06.2020 përmes vendimit nr. 554/20 tani paditësit ia ka ndaluar shitjen e disa produkteve dhe sasive të evidentuara sipas procesverbalit të ri-inspektimit nga inspektorët fitosanitar nr. 001630, 001631 të datës 25.06.2020, ka specifikuar se ndalesa vlen vetëm për produktet si: Leopard 24 paketime, Luna 20 paketime, Movento 4 paketime, Prosao 250 EC 2 paketime, Kohinor 48 paketime, pasi që subjekti afarist tani paditësi ka vepruar në kundërshtim me urdhër ndalesën të shqiptuar sipas vendimit paraprak nga e paditura.

25. Lidhur me këtë, gjykata fillimisht shqyrtoi ligjshmërinë e aktit administrativ të kontestuar me padi nr. 554/20 të datës 30.06.2020, përkitazi edhe me përmbajtjen e aktit administrativ duke iu referuar nenit 48 të LPPA-së, i cili përcakton se: “1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij*”, si dhe nenit 52 i cili përcakton se: “*Paligjshmëria e aktit administrativ 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit.*”.

26. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se akti i kontestuar nuk përmban të dhëna të sakta e për shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi. Konstatimi se PMB-të janë

me mbi etiketime, etiketën bazë e kanë në gjuhën Serbe, ndërsa mbi këtë është vendosur etiketë në gjuhën shqipe, mirëpo janë të shënuara të dhëna jo të mjaftueshme për etiketim, është i paqarte se cka nënkupton me mbi etiketime dhe cka mungon në këto të dhëna. Për Preparatet “Leopard” 5EC 1/1 .32 paketime, “Orius” 15 EË 5 paketime, “Equip” 5 paketime, “Luna” 2 paketime, “Decis” 2,5 EC 19 paketime, “Movento” 100 SC 4 paketime, “Prosario” 2 EC 2 paketime, “Folpan” 80 EË 75 paketime – e paditura nuk thot asgjë se cka është konstatuar dhe cka mungon për secilin produkt. Ndërsa për produktin Kohiemr 7005 SL =480x0,01litra cek se etiketa në gjuhën shqipe skenohet numri i regjistrimit ndërsa në etiketën bazë ka numër 2454. Orius” 25 EË në sasi prej 240 copë x 0,05 litra, tek i cili është i shtypur nr. 510, ndërsa preparati “Mavrik” 2F në sasi 36 copë x 0,25; litra ka numrin 487 - e paditura nuk jep asnjë sqarim kur thot se *skenohet numri i regjistrimit ndërsa në etiketën bazë ka numër 2454*. Pra cka nënkupton nr. i regjistrimit në MBPZHR dhe si duhet të paraqitet atëherë në raport me numrin në etiketën bazë.

27. Po ashtu e paditura për Preparati “Adengo” në sasi 39 copë X0,200 litra deklaron se ka udhëzimin bazë të përdorimit në gjuhën serbe me alfabet cirilik, ndërsa mbi këtë udhëzim e ka të vendosur etiketën në gjuhën shqipe – atëherë shtrohet pyetja se çka nuk është në rregull këtu pra nëse etiketa në gjuhën shqipe nuk përmban udhëzimin e përdorimit dhe është e vendosur mbi udhëzimin bazë të përdorimit në gjuhën serbe duke e bërë të paqasshëm udhëzimin apo në çka konsiston kundërligjshmëria duke ju referuar edhe bazës ligjore që përcakton procedurën e vendosjes së numrit të regjistrimit në MBPZHR dhe ku qëndron falsifikimi siç pretendon e paditura dhe për këtë arsye subjekti afarist i ndalon distribuimin dhe tregtimin e PMB-ve me arsyetim se është në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-042 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 17/2014.

28. Ndërsa e paditura më datë 30.06.2020 përmes vendimit nr. 554/20 tani paditësit ia ka ndaluar shitjen e disa produkteve dhe sasive të evidentuara sipas procesverbalit të ri-inspektimit nga inspektorët fitosanitar nr. 001630, 001631 të datës 25.06.2020, ka specifikuar se ndalesa vlen vetëm për produktet si: Leopard 24 paketime, Luna 20 paketime, Movento 4 paketime, Prosao 250 EC 2 paketime, Kohinor 48 paketime, pasi që subjekti afarist tani paditësi ka vepruar në kundërshtim me urdhër ndalesën të shqiptuar sipas vendimit paraprak nga e paditura.

29. Prandaj gjykata vlerëson e paditura merr vendim bazuar ne një vërtetim te mangët te gjendjes faktike bazuar ne konstatime konfuze, te pa qarta dhe te pa bazuara ne prova, dhe bazuar ne arsyetim nuk jep asnjë sqarim se cilat fakte janë vendimtare per marrjen e vendimit dhe duke sqaruar rëndësinë e fakteve te konstatuara. Prandaj Vendimi i kundërshtuar është i përfshire ne shkelje thelbësore e dispozitave të LPPA-së, pasi që nuk përmban elementet e aktit administrativ, rrjedhimisht i padituri ka dhënë arsye te pamjaftueshme se mbi bazën e cilave prova ka konstatuar gjendjen faktike si në vendimin e atakuar.
30. Gjykata vlerëson se Ligji nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve mbi bazën e të cilit gjen mbështetje ligjore akti i kontestuar me padi përcakton se ky ligj rregullon klasifikimin, ambalazhimin, dhe etiketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve në pajtueshmëri me Direktivat e Komisionit Evropian, ndërsa në nenin 51 pika 1.6 parasheh se *“ndalon plasmanin në treg të PMB, nëse ato nuk janë në pajtim me autorizimin, paketimin, etiketimin, klasifikimin, lejet, udhëzimet për përdorim, përbërjet kimike. Neni 5 i Udhëzimit Administrativ Nr.13/2009 për caktimin e kushteve, objekteve dhe pajisjeve për vendosjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve, në paragrafin 1 përcakton se ‘në ambalazh, duhet të vendoset etiketa në gjuhën e përdoruesit’*, ndërsa në paragrafin 4 përcakton se *“ndalohet në etiketë që të bëhen korrigjime, fshirje ose të vendoset etiketë tjetër”*. Mirëpo, gjykata rikujton se mospajtimet me autorizimin, paketimin, etiketimin, klasifikimin, lejet, udhëzimet për përdorim, përbërjet kimike, korrigjime, fshirje dhe cdo parregullsi duhet te konstatohet ne mënyrë te qarte qe nuk len dyshime për vërtetimin e tyre dhe te bazohen ne prova te mjaftueshme.
31. Gjykata refuzoj kërkesën për kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e ndalesës së shitjeve të preparateve për mbrojtjen e bimëve në shumë prej 23,538.72 euro pasi që nga provat e administruara nuk u vërtetua dem i real qe i është shkaktuar paditësi, sepse sipas vendimit te kundërshtuar e paditura ka konstatuar qe një sasi e preparateve te ndaluara për shitje tani me janë shitur. Përveç qe e paditura nuk ka dhënë detaje te mjaftueshme sa i përket sasisë se produkteve te shitura, ne anën tjetër paditësi nuk ka ofruar asnjë prove për te dëshmuar se preparatet e ndaluara nuk janë shitur. Sipas Nenit 7 te LPK përcaktohet 7.1. *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat*

i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.
7.2 Gjykata është e autorizuar ti vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

32. Në rrethanat e tilla gjykata konstaton se nga shqyrtimi i provave nuk është vërtetuar drejte gjendja faktike në vendimin e kundërshtuar me padi, nr. 554/2020 të datës 30.06.2020 i lëshuar nga e paditura, dhe nuk është vërtetuar dem i pretenduar nga paditësi. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzimet procedurale u mire në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.545/22, datë 31.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.